



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova/Ministry of
Internal Affairs**

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar / Departament za Reintegraciju
Repatriраних Lica / Department for Reintegratin of Repatriated Persons

Udhëzues për ndihmë dhe mbështetje të personave të riatdhesuar
për riintegrim të qëndrueshëm bazuar në politikat e riintegrit



Prishtinë, Maj 2014

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave	3
Kapitulli I - Dispozitat e përgjithshme	4
1.1. Qëllimi.....	4
1.2. Fushëveprimi	4
1.3. Parimet	4
Kapitulli II – Ripranimi dhe riatdhesimi.....	6
2.1. Masat para ripranimit	6
2.2. Pranimi në aeroport	7
2.3. Asistenca në momentin e arritjes	8
Kapitulli III – Arritja në komunë - Vlerësimi i nevojave	10
3.1. Procesi për vlerësim të nevojave	10
3.2. Përdorimi i të dhënave për qëllim të politikave	10
Kapitulli IV – Afrimi i shërbimeve emergjente për personat e cenuneshëm me vëmendje të veçantë për familjet me fëmijë	11
Kapitulli V – Afrimi i ndihmës dhe mbështetjes për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar	12
5.1. Banimi	12
5.2. Arsimi.....	13
5.2.1. Sigurimi i qasjes në shkollë për fëmijët e riatdhesuar	14
5.2.2. Afrimi i arsimit cilësor.....	15
5.3. Shëndeti.....	16
5.4. Regjistrimi civil.....	17
5.5. Mirëqenia sociale dhe punësimi.....	18
5.5.1. Asistenca sociale dhe qasja në beneficione	18
5.5.2. Integrimi ekonomik përmes aftësimit profesional, përkrahjes në punësim dhe vetëpunësimit.....	19
Kapitulli VI – Sistemi i menaxhimit të rastit	21
Kapitulli VII. Modalitetet e koordinimit ndërmjet akterëve në nivelin qendror dhe lokal.....	22
7.1. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin qendror	22
7.2. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin lokal	23
7.3. Koordinimi vertikal	24
Kapitulli VIII – Menaxhimi i fondeve	25
8.1. Alokimi i buxhetit shtetëror për Fondin e Riintegrit	25
8.2. Monitorimi i shfrytëzimit të fondeve	25
Kapitulli IX - Monitorimi dhe vlerësimi.....	26
9.1. Monitorimi i progresit	26
9.2. Llogaridhënia.....	26
9.2.1. Mjetet juridike për realizimin e të drejtave për personat e riatdhesuar	26
9.2.2 Llogaridhënia e akterëve.....	27

Lista e shkurtesave

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
AP	Aftësim Profesional
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DRPR	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Riintegrim
KQR	Komisioni Qendror për Riintegrim
LEB	Listën Esenciale të Barnave
MAPL	Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NDP	Ndërmjetësim të Drejtpërsëdrejti në Punësim
OJQ	Organizata Joqeveritare
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosoves
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPMS	Qendra e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale për Punë
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
PSO	Procedurat Standarde Operative
RKS	Republika e Kosovës
SMR	Sistemi i Menaxhimit të Rasteve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKP	Zyra Komunale e Punësimit

Kapitulli I. Dispozitat e përgjithshme

1.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzuesi është sigurimi i implementimit të koordinuar dhe të integruar të Rregullores QRK nr. 20/2013 në mënyrë që të garantojë ofrimin e shërbimeve adekuate për personat e riadhesuar, me vëmendje të veçantë në nevojat e fëmijëve dhe kategorive tjera të cënueshme.

Riintegrimi i personave të riadhesuar është proces afatgjatë, përtej praktikave të ripranimit dhe përkrahjes fillestare. Prandaj, qëllimi është që të ofrohen zgjidhje të qëndrueshme për riintegrim në shoqërinë kosovare.

Udhëzuesi ka për qëllim:

- (1) Të përcaktojë rolin përkatës të akterëve të ndryshëm;
- (2) Të përcaktojë modalitetet për koordinim ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, brenda kompetencave përkatëse;
- (3) Të përcaktojë modalitetet për koordinim horizontal ndërmjet sektorëve në nivelin qendror dhe atë lokal, brenda kompetencave përkatëse;
- (4) Të sigurojë lidhjet ndërmjet sistemit të aplikueshëm për personat e riadhesuar dhe sistemit të përgjithshëm për riintegrim të qëndrueshëm;
- (5) Të detajojnë procesin e menaxhimit të fondeve për riintegrimin e personave të riadhesuar;
- (6) Të përcaktojë mekanizmat adekuat të monitorimit dhe llogaridhënies.

1.2. Fushëveprimi

Udhëzuesi ka të bëjë me riintegrimin e personave të riadhesuar në harmoni me fushëveprimin dhe kriteret bazë të përcaktuara në Rregulloren QRK Nr. 20/2013, duke përfshirë aplikimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me kujdes të duhur ndaj interesave më të mira për fëmijë.

Poashtu personat e cënueshëm kanë nevojë për masa të veçanta të riintegrit. Personat e riadhesuar konsiderohen të cënueshëm për shkak të moshës, kapacitetit të zvogëluar funksional si pasojë e sëmundjes apo aftësisë së kufizuar, si pasojë e gjendjes së tyre familjare, gjinisë, analfabetizmit, ose persona të cilëve u mungojnë njohuri adekuate të gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Udhëzuesi merr në konsideratë faktin që procesi i riadhesimit dhe riintegrit ndodh në faza të ndryshme. Ai fillon në vendin dërgues dhe përfundon me riintegrim të plotë në shoqërinë kosovare. Ky proces përfshin si ndihmën e menjëhershme pas arritjes ashtu edhe ndihmën dhe mbështetjen për riintegrim të qëndrueshëm dhe përfshirjen në shoqëri.

1.3. Parimet

Udhëzuesi udhëhiqet nga parimet gjithëpërfshirëse, që dalin nga e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti të drejtat e fëmijëve, standardet dhe parimet e qeverisjes së mirë.

Parimet për të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e fëmijëve, përfshijnë:

- (1) *Pandashmërinë dhe ndërvarësinë.* Zbatimi i Udhëzuesit duhet të ketë qasje ndërsektoriale dhe të integruar të të gjitha fushave që prekin jetën e personave të riatdhesuar, duke kërkuar koordinim të shtuar ndërmjet të gjithë akterëve të përfshirë në proces.
- (2) *Univerzalitetin, mos-diskriminimin dhe vëmendjen e veçantë për nevojat e personave të cenueshëm.* Përmes këtij udhëzuesi i kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të personave të riatdhesuar të cenueshëm, integrimi i të cilëve kërkon masa të veçanta.
- (3) *Interesat më të mira për fëmijët.* Interesat më të mira për fëmijët janë fokusi kryesor në të gjitha aspektet e procesit të riintegritimit. Gjatë vendimarrjes, autoritetet publike dhe akterët tjerë relevant duhet të marrin në konsideratë efektet e mundshme të atij vendimi në jetët e fëmijëve.
- (4) *E drejta për jetesë, mbijetesë dhe zhvillim.* Udhëzuesi ka për qëllim të siguroj mundësitë maksimale për zhvillim fizik, mendor, shpirtëror dhe psikologjik për fëmijët e riatdhesuar, në veçanti të atyre me rrezikshmëri të lartë të marginalizimit.
- (5) *E drejta për t'u dëgjuar për të gjithë personat e riatdhesuar, duke përfshirë fëmijët dhe grupet tjera të cenueshme.* Vendimet individuale dhe kolektive, ofrimi i shërbimeve e llogaridhënia dhe mekanizmat tjerë që ndikojnë në personat e riatdhesuar, duhet të marrin në konsideratë edhe pikëpamjet e tyre, duke përfshirë fëmijët dhe personat tjerë të cenueshëm.

Udhëzuesi promovon parimet e qeverisjes së mirë duke përfshirë:

- (1) *Respektimin e sundimit të ligjit.* Udhëzuesi mbështet respektimin e legjislacionit ekzistues nga të gjithë akterët, forcon zbatimin dhe fuqizon legjislacionin ekzistues dhe synon të sigurojë mjete juridike efektive në rast të moszbatimit.
- (2) *Qëndrueshmëria.* Udhëzuesi ka për qëllim të sigurojë riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, duke siguruar zhvendosje nga ndihma emergjente në zgjidhje të qëndrueshme.
- (3) *Transparenca.* Udhëzuesi ndihmon në sigurimin që bartësit e të drejtave janë plotësisht të vetëdijshëm lidhur me të drejtat e tyre dhe kuptojnë proceset për të kërkuar ato. Udhëzuesi promovon standarde të transparencës në alokim të resurseve dhe shpenzimeve.
- (4) *Llogaridhënia.* Udhëzuesi promovon mekanizmin e llogaridhënies për të siguruar që bartësit e detyrave përmbushin rolin e tyre në mënyrë efektive, në harmoni me të drejtat e njeriut dhe parimet e qeverisjes së mirë.
- (5) *Subsidiariteti.* Udhëzuesi i referohet nivelit lokal në pajtim me kompetencat e specifikuar në Rregulloren 20/2013, me përkrahje nga niveli qendror, sipas nevojës.

Kapitulli II. Ripranimi dhe riatdhesimi

2.1. Masat para ripranimit

Akterët kryesorë: MPB Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM), Departamentin për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar (DRPR).

Veprimi për rastet individuale

Vendi kërkues dërgon DSHAM-së listën me emrat e personave të cilët janë në procedurë të riatdhesimit. Me pranimin e listës, DSHAM kërkon nga homologu i vendit kërkues të siguroj dokumentet shoqëruese, në veçanti kur personat e riatdhesuar përfshijnë familje me fëmijë.

Këto dokumente përfshijnë:

- (1) Certifikatën e lindjes dhe dokumentet tjera të regjistrimit civil;
- (2) Certifikatën/diplomën e nivelit të shkollimit;
- (3) Informatat për shëndetin, duke përfshirë imunizimin, sëmundjet dhe gjendjen shëndetësore, si dhe informata tjera relevante rreth shëndetit;
- (4) Dëshminë nëse ekziston aftësia e kufizuar mendore apo fizike;
- (5) Njoftimin nëse ka të kaluar kriminale;
- (6) Ndonjë informatë tjetër të rëndësishme që do të shërbejë në mbështetje të riintegrit të personave të riatdhesuar.

DSHAM duhet të bëj kërkesën për dokumentet e lartpërmendura së bashku me aprovimin për ripranim të dorëzuar te vendi kërkues. DSHAM dhe DRPR bashkëpunojnë ngusht para, gjatë dhe pas procesit të ripranimit.

Nëse informatat lidhur me shëndetin zbulojnë se personi i riatdhesuar ka gjendje të rëndë shëndetësore për të cilën nuk ka trajtim në Kosovë, DSHAM e informon vendin kërkues brenda 24 oreve.

Veprimet për praktika të qëndrueshme

DSHAM në koordinim me DRPR përgatitë listën e informatave dhe dokumenteve bazë të personave të riatdhesuar, që vendet dërguese duhet të kenë parasysh me rastin e kthimit. Formulari i informatave dhe dokumentet përcjellëse do të publikohen në ueb faqen e MPB-së. Kjo listë përfshin, por nuk kufizohet në dokumentet e përcaktuara më lartë. Në marrëveshjet bilaterale për ripranim MPB do të merr parasysh informatat e nevojshme dhe dokumentacionin përcjellës për personat e riatdhesuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe QKUK përgatisin listën e sëmundjeve që nuk trajtohen në Kosovë. Lista publikohet në ueb faqen e MSH-së dhe i dërgohet MPB-së (DSHAM dhe DRPR).

Pas pranimit të njoftimit për kthim të personave me gjendje të rëndë shëndetësore, fëmijëve të pashoqëruar, personave me nevoja të veçanta dhe kategorive tjera që i takojnë grupeve të cënueshme, MPB-ja (DSHAM dhe DRPR) koordinon pritjen e organizuar me MSH-në, MPMS-në dhe akterët tjerë relevantë.

DSHAM njofton MSH-në dhe MPMS-në se paku pesë (5) ditë para kthimit me qëllim që të organizohen ekipet e pritjes në ANP. Njoftimi i dërgohet zyrtarit të emëruar si pikë e kontaktit në procesin e riintegrit për ministrinë përkatëse. Po ashtu, gjatë tërë procesit mbahet i informuar edhe DRPR, veqanërisht Zyra Pritese në ANP.

2.2. Pranimi në aeroport

Akterët kryesorë: MPB-ja - Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM), Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar.

Organizimi i pranimi në aeroport: MPB-ja siguron prezencën e së paku dy zyrtarëve të pranimi në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, njëri nga të cilët duhet të jetë i gjinisë femërore.

Me rastin e kthimeve të organizuara sigurohet kapaciteti i mjaftueshëm i resurseve njerëzore me qëllim të përshpejtimit të procedurave të riprimit. Në orarin e rregullt, MPB-ja siguron prezencën e zyrtarëve të cilët flasin gjuhët zyrtare të RKS-së.

Kur DSHAM lajmërohet nga vendi dërgues që personat e riatdhesuar nuk komunukojnë në njëren nga gjuhët zyrtare të RKS-së, DSHAM dhe DRPR sigurojnë përkthyes për gjuhët përkatëse.

Formularët e pranimi do të jenë të disponueshëm në zyrën pritëse të riintegrit të cilët do të plotësohen me rastin e arrijtes së personave të riatdhesuar në ANP.

Përgatitja e materialit informues

MPB-ja përgatit fletushka informuese për të drejtat dhe obligimet e personave riatdhesuar me të gjitha informatat për ndihmën dhe përfitimet sipas Rregullores QRK nr. 20/2013, si dhe informatat për shërbimet themelore që ofrohen në komunën e destinimit. Shtojcë e fletushkave do të jenë të gjitha kontaktet e institucioneve relevante për ndihmë dhe mbështetje. Fletushkat janë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe, rome, turke dhe angleze, të cilat iu shpërndahen personave të riatdhesuar në momentin e arrijtes. Fletushkat në versione të favorshme për fëmijët janë gjithashtu në dispozicion në këto gjuhë, me theks në të drejtat e fëmijëve, shkollim, edukim dhe mjetet juridike të qasshme për shkelje të të drejtave të fëmijëve.

Koordinimi me organizatat tjera tek ANP-ja

DRPR-ja koordinon pritjen e personave të riatdhesuar me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare të pranishme në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në pajtueshmëri me mandatet e tyre përkatëse. Memorandumi i Mirëkuptimit me këto organizata specifikon rolet përkatëse dhe parasheh llojin e përkrahjes që ata mund të ofrojnë, brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre. Procesi duhet të synojë të sigurojë në veçanti prezencën e punëtorit social dhe/ose psikologut për të identifikuar vështirësitë dhe për të dhënë përkrahjen fillestare për personat e riatdhesuar me të arritur në vend.

2.3. Asistenca në momentin e arritjes

Informimi në momentin e arritjes

Zyrtarët pranues në aeroport informojnë personat e riatdhesuar për:

- (1) Procesin e përgjithshëm të riintegrit;
- (2) Të drejtat e tyre për përfitim nga programi dhe skemat në dispozicion sipas Rregullores QRK 20/2013;
- (3) Vendin e parashtrimit të kërkesave për ndihmë dhe mbështetje në komunën e destinacionit, në veçanti rolin e ZKKK-së;
- (4) Mjetet juridike në dispozicion në rast të mos përmbushjes së të drejtave;

Zyrtarët pranues i ofrojnë personave të riatdhesuar fletushkat e informimit.

Vlerësimi i nevojave fillestare

Zyrtarët pranues bëjnë vlerësimin e nevojave fillestare në bazë të dokumentacionit në dispozicion dhe intervistës me personat e riatdhesuar.

Vlerësimi i nevojave fillestare shqyrton:

- (1) Nevojën për ndihmë emergjente;
- (2) Gjendjen socio-ekonomike të familjes;
- (3) Ekzistencën e rrjetit përkrahës, si p.sh. të afërmit në Kosovë;
- (4) Gjuhën(t) e folura nga secili anëtar i familjes, duke përfshirë zotërimin nga fëmijët të gjuhëve zyrtare në Kosovë për qëllime shkollimi;
- (5) Strukturën familjare dhe cenushmërinë, nevojat e parashikuara të fëmijëve në varësi nga mosha e tyre, gjendja ekonomike, nevojat specifike/aftësitë e kufizuara, niveli shkollor, gjuha, përkatësia etnike, si dhe kritere tjera relevante.
- (6) Përgjigjet në pyetjet e tyre;
- (7) Detektimin e çështjeve problematike brenda familjeve të riatdhesuara, evidentimin e tyre në sistemin e menaxhimit të rastit dhe adresimin në DRPR për veprime të mëtejshme.

Regjistrimi i të dhënave në SMR

Zyrtarët pranues regjistrojnë informatat në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (SMR) brenda njëzet e katër (24) orëve nga pranimi i personave të riatdhesuar. Çështjet që kërkojnë vëmendje të veçantë evidentohen në sistem dhe raportohen drejtpërdrejt në DRPR për veprim të mëtutjeshëm.

Sigurimi i transportit

Zyrtarët e pritjes organizojnë transportin e personave të riatdhesuar nga ANP deri në qendrën e akomodimit të përkohshëm apo komunën e destinacionit, nëse personi i riatdhesuar nuk ka mundësi të arrijë në vendin e destinacionit në të njëjtën ditë.

Trajnimi i zyrtarëve pranues

MPB siguron trajnime të zyrtarëve përgjegjës për riatdhesim dhe riintegrim.

Secili zyrtar pas pranimit të detyrës duhet të trajnohet në lidhje me:

- (1) Legjislacionin në fuqi, duke përfshirë të drejtat dhe proceset për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
- (2) Përvojën e personave të riatdhesuar prej largimit të tyre nga vendi dërgues deri në integrimin e tyre;

- (3) Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen personat e riatdhesuar të cilët paraqesin rrezik të përjashtimit, posaçërisht fëmijët dhe mundësitë në dispozicion për adresimin e nevojave të tyre;
- (4) Aftësitë për komunikim efikas me personat e riatdhesuar, duke pasur parasysh që ata mund të jenë të shqetësuar me të arritur në vend;
- (5) Aftësitë për vlerësimin fillestar të nevojave të personave të riatdhesuar, duke përfshirë identifikimin e specifikave të cenushmërisë;
- (6) Aftësitë për adresimin e situatave emergjente, duke përfshirë emergjencat shëndetësore;
- (7) Përdorimin e sistemit të menaxhimit të rastit;
- (8) Mjetet juridike ekzistuese për personat e riatdhesuar të drejtat e të cilëve nuk janë realizuar.

Secili zyrtar i angazhuar në riatdhesim dhe riintegrim do të trajnohet në vazhdimësi për ndryshimin e procedurave dhe/ose legjislacionit lidhur me:

- (1) Evolucionet e proceseve;
- (2) Evolucionet e trendeve për riatdhesim nga vendet dërguese;
- (3) Pasurimi i sistemit të menaxhimit të rasteve me module të reja dhe;
- (4) Fuqizimi i kapaciteteve për ndërveprim efikas me personat e riatdhesuar.

Strehimi i përkohshëm

Personat dhe familjet që kanë nevojë për shfrytëzimin e strehimit të përkohshëm janë kryesisht ata persona/familje që nuk kanë përkrahje nga rrjeti familjar brenda Kosovës. Strehimi i përkohshëm iu sigurohet personave të riatdhesuar të cilët pas arritjes nuk kanë në dispozicion mundësi të tjera të akomodimit. Strehimi i përkohshëm ofrohet deri në 7 ditë ku ofrohen edhe shërbimet e tjera elementare, si ushqim i gatshëm dhe trajtim mjekësor sipas nevojës.

Qendra e akomodimit të përkohshëm menaxhohet nga DRPR.

Zyrtarët përgjegjës në Qendrën e Akomodimit informojnë personat e strehuar në Qendër për:

- (1) Procesin e përgjithshëm të riintegrit;
- (2) Të drejtat e tyre për përfitim nga programi dhe skemat në dispozicion sipas Rregullores QRK 20/2013;
- (3) Vendin e parashtrimit të kërkesave për ndihmë dhe mbështetje në komunën e destinacionit, në veçanti rolin e ZKKK-së;
- (4) Mjetet juridike në dispozicion në rast të mospërmbushjes së të drejtave;
- (5) Përgjigjet në pyetjet e tyre;
- (6) Detektimin e çështjeve problematike brenda familjeve të riatdhesuara, raportimin e tyre në sistemin e menaxhimit të rastit dhe referimin sipas nevojës të akterëve relevantë (MPB-ja, MPMS-ja) për veprime të mëtejshme.

Zyrtarët përgjegjës, brenda njëzet e katër (24) orëve pas arritjes së personave në Qendrën e Akomodimit, informojnë Kordinatorin Rajonal për personat e strehuar në qendër me qëllim të verifikimit të rastit dhe ndihmës për akomodim me qira, në rast nevojë.

Kapitulli III. Arritja në komunë - Vlerësimi i nevojave

Akterët kryesorë: Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) me përkrahje nga Qendra për Punë Sociale (QPS), në koordinim me drejtoratet tjera komunale (shëndetësi, arsim, mirëqenie sociale dhe drejtorateve tjera).

3.1. Procesi për vlerësim të nevojave

Brenda 5 ditëve pas arritjes së familjes së riatdhesuar në komunë, ZKKK-ja me përkrahje nga Qendra për Punë Sociale bën vlerësimin e përgjithshëm të nevojave të familjes. Ky vlerësim i nevojave kryhet përmes shqyrtimit të informatave në sistemin e menaxhimit të rastit, dokumentacionit të ofruar nga familjet dhe intervistave me anëtarët e familjes.

Zyrtari i ZKKK-së dhe punëtori social nga QPS-ja së bashku kryejnë intervistimin e personave të riatdhesuar. Fëmijët intervistohen ndaras nga prindërit. Vlerësimi i kushton vëmendje të veçantë nevojave të fëmijëve dhe personave të cenueshëm.

Vlerësimi i nevojave shqyrton në veçanti:

- (1) Gjendjen e banimit;
- (2) Kushtet socio-ekonomike;
- (3) Struktura e familjes;
- (4) Disponueshmërinë e dokumentacionit, duke përfshirë dokumentet e gjendjes civile dhe ato shkollore;
- (5) Gjendja shëndetësore duke përfshirë shëndetin mendor që kërkon vëmendje mjekësore;
- (6) Aftësitë e kufizuara;
- (7) Njohuritë gjuhësore;
- (8) Aftësitë profesionale, mundësinë e punësimit dhe nevojën e mundshme për trajnim profesional;
- (9) Cenushmëritë specifike duke përfshirë rrezikun nga marginalizimi, dhunën në familje dhe fëmijët në rrezik nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi;
- (10) Ekzistencën e rrjetit mbështetës (të afërm apo miq);
- (11) Çfarëdo informate tjetër relevante.

Vlerësimi i nevojave nënshkruhet bashkërisht nga ZKKK-ja, QPS-ja dhe Koordinatori Rajonal/DRPR. ZKKK-ja regjistron vlerësimin e nevojave në sistemin e menaxhimit të rastit brenda 5 ditësh.

Në rast se kërkohet veprim emergjent, ZKKK-ja i drejtohet DRPR-së përmes Koordinatorit Rajonal brenda 24 orëve. DRRP ndërmerr veprimet relevante, duke u koordinuar sipas nevojës me akterët relevant.

3.2. Përdorimi i të dhënave për qëllim të politikave

ZKKK-ja analizon të dhënat e mbledhura nga vlerësimi i nevojave në sistemin e menaxhimit të rastit dhe i shfrytëzon ato për përcaktimin e masave prioritare të politikave dhe për të raportuar lidhur me progresin. Koordinatori Rajonal i MPB-së ka gjithashtu qasje në të dhëna, në mënyrë që të përkrahë ZKKK-në në planifikimin e masave dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të përbashkëta sipas nevojës.

Kapitulli IV. Ofrimi i shërbimeve emergjente për personat e cenuneshëm me vëmendje të veçantë për familjet me fëmijë

Akterët kryesorë: Komunitat, Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar) Ministria e Shëndetësisë.

Banimit përmes qirasë

Nga banimi përmes qirasë përfitojnë personat e riatdhesuar nëse ata nuk kanë në dispozicion mundësi tjera akomodimi dhe për shkak të kushteve të vështira ekonomike nuk mund të përballojnë të paguajnë vet shpenzimet e banimit. Bonusi për banim do t'ju sigurohet për një periudhë gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi për gjashtë (6) muaj tjerë. Qiraja kontrahohet sipas ofertës, çmimi përcaktohet në bazë të ofertës më të lirë për komunitet përkatese. Për arsye të veçanta kur personat e riatdhesuar nuk kanë asnjë mundësi tjetër të akomodimit, afati mund të zgjatet edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Me skadimin e afatit të fundit për akomodim komunitet përkatese në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit, është e obliguar të sigurojë banim të qëndrueshëm. Komunitet përkatese është përgjegjëse për sigurimin e banimit, bonusit të banimit të përshtatshëm për personat e riatdhesuar pas periudhës së riintegritit prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

Pakot e ndihmës

Pakot e ndihmës duhet të sigurohet për personat e riatdhesuar të cilët për shkak të gjendjes së tyre të vështirë ekonomike dhe sociale nuk janë në gjendje t'i sigurojnë këta artikuj vetë. Kjo pako ofrohet për personat/familjet e riatdhesuara deri në qasjen e tyre në skemat sociale, apo krijimit të hyrave përmes punësimit apo skemave tjera të përfitimit.

Personat e riatdhesuar të cilëve iu është siguruar strehimi i përkohshëm sipas Rregullores QRK Nr.20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegritit, kanë të drejtë të përfitojnë pakot e ndihmës menjëherë pas hyrjes në strehim. Pakot sigurohet, gjatë periudhës prej gjashtë (6) muajsh me mundësi vazhdimi për gjashtë (6) muaj të tjerë, gjithsejtë dymbëdhjetë (12) muaj.

Trajtimi mjekësor

Ndihma mjekësore sigurohet menjëherë pas arritjes nëse nevoja për këtë ndihmë i është komunikuar DRPR-së nga shteti dërgues para arritjes. Në rast nevojë kujdesi mjekësor sigurohet edhe pa informim paraprak nga mjekët e aeroportit. Në rastet specifike personat e riatdhesuar mund të aplikojnë për mbulimin e shpenzimeve për trajtim mjekësor i cili nuk afrohet nga institucionet publike dhe medikamentet që nuk gjenden në Listën Esenciale të Barnave (LEB).

Trajtimi psiko-social në rast nevojë

Në rastet specifike personat e riatdhesuar mund të aplikojnë për mbulimin e shpenzimeve për trajtim mjekësor i cili nuk afrohet nga institucionet publike, për trajtim psiko-social në rast nevojë, si dhe për mbulimin e shpenzimeve për medikamentet të cilat nuk gjenden në Listën Esenciale të Barërave (LEB).

Pako dimërore

Pakot e ndihmës për dimër mund të sigurohet për personat të cilët për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe sociale, nuk mund t'i sigurojnë vetë lëndët djegëse. Pakot për dimër shpërndahet vetëm një herë personave/familjeve të riatdhesuara të cilat kthehen gjatë sezonit të dimrit dhe mund të shfrytëzojnë këtë pako për ngrohje.

Kapitulli V. Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar

5.1. Banimi

Akterët kryesorë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komunitet dhe Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar.

Krijimi i Kushteve për Banim të Qëndrueshëm

Komuna përkatëse në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, është e obliguar të siguroj banim të qëndrueshëm për personat që nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

Përgjegjësitë e komunave:

Komuna e Kosovës harton programet tre vjeçare të banimit sipas nenit 25 të Ligjit Nr. 03/164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit. Në këtë program përfshihen nevojat e parapara për banim për personat e riatdhesuar. Hartimi i programit bëhet sipas udhëzuesit për hartimin e programeve tre (3) vjeçare të banimit në kuadër të ligjit.

Nevojat e parapara për banim të personave të riatdhesuar bazohen në numrin mesatar të personave të riatdhesuar në atë komunë që kanë kërkuar banim afatgjatë gjatë tri viteve parapra.

Planet tri vjeçare hartohen në harmonizim me planet zhvillimore urbane komunale. Me rastin e sigurimit të banimit vëmendje e duhur i kushtohet afërsisë së shkollës për fëmijët apo disponueshmërisë së transportit publik për në shkollë. Në disa objekte mundësohet edhe qasja për personat me aftësi të kufizuara.

Komuna, drejtoria përgjegjëse, sektori ose zyrja që mbulon fushën e banimit pas evidentimit të kërkesave, si dhe planifikimit buxheor në nivel komunal të dedikuar për banim, bëjnë shpalljen publike për programet me qira joprofitabile dhe bonus banimi apo financimin e ndërtimit të objekteve banesore.

Këto programe realizohen në:

- banesat e ndërtuara nga komuna, qeveria apo donatorët,
- banesat ekzistuese në pronësi të personave fizik apo juridik të cilat jepen me qira, dhe
- banesat tjera në pronësi të komunës që mund të adaptohen për shfrytëzim.

Në rastet kur komuna nuk mund të përmbushë nevojat e saj me të hyrat vetanake, mund të paraqesë kërkesën në MMPH, e cila duhet të shoqërohet me një përshkrim të detajuar të kostos.

MMPH bën planifikimin buxhetor për përkrahje në komuna, në baza vjetore në financimin e objekteve banesore dhe subvencionim e qirasë.

Komunitet mund të bëjnë marrëveshje me donatorë ndërkombëtarë, OJQ, dhe sektorin privat për të përkrahur ndërtimin e banimit social për personat e riatdhesuar.

Renovimi ose rindërtimi i shtëpive për persona të riatdhesuar:

Personat e riatdhesuar mund të përfitojnë renovim ose rindërtim të shtëpive të tyre nëse ata dëshmojnë se shtëpia e tyre në të cilat ata kanë jetuar më herët, është plotësisht ose pjesërisht

e shkatërruar. Personat e riatdhesuar të cilët kanë qenë përfitues të kësaj skeme nga ndonjë program në fushën e banimit nuk kanë të drejtë në këtë ndihmë. Dokumentet e nevojshme që dëshmojnë pronësinë, dokumentet e dëmtimeve ose shkatërrimeve të pronës, si dhe pëlqimin e komunës për renovim apo rindërtim edhe vërtetimin se nuk është përfitues i ndonjë programi të mëhershëm për këtë qëllim, duhet t'i bashkëngjiten kërkesës. Shtëpia e rinovuar apo rindërtuar duhet të shfrytëzohet për banim nga personi/familja e riatdhesuar.

Mobilimi/inventarizimi i shtëpive:

Pakoja e orendive mund të sigurohet për personat e riatdhesuar nëse atyre iu mungojnë orenditë dhe kanë nevojë për këtë pako. Përmbajtja e pakos së orendive është specifikuar në Rregullores QRK Nr.20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrit. Pakoja e orendive mund të sigurohet vetëm një herë.

Atribuimi i banimit për familjet e riatdhesuara

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim merr pjesë në organin kompetent për atribuimin e banimit social. Ajo raporton zgjidhjet e qëndrueshme të banimit në sistemin e menaxhimit të rastit. Ajo përfshin në raportin vjetor për DRPR-në numrin dhe karakteristikat e familjeve të riatdhesuara që kanë përfituar nga program i banimit.

Menaxhimi i rasteve të banimit

Zyrtarët e pritjes të ANP-së identifikojnë nevojat për banim dhe i shënojnë ato në bazën e të dhënave (SMR) të cilësuar si prioritet, duke përfshirë strukturën e familjes, moshën e fëmijëve, gjendjen shëndetësore, përkatësinë etnike, aftësitë e kufizuara, nivelin e shkollimit dhe nivelin e njohjes së gjuhëve zyrtare të RKS-së.

DRPR-ja përgatitë raport analitik çdo vit lidhur me nevojat për banim pas 12 muajsh dhe zgjidhje të qëndrueshme.

5.2. Arsimi

Akterët kryesorë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Komunitat (Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim), Ministria e Punëve të Brendshme (DRPR).

Arsimi është segment i rëndësishëm i riintegrit të fëmijëve të riatdhesuar. Jo vetëm që siguron që fëmijët zhvillojnë aftësi për t'u bërë pjesëtarë aktiv të shoqërisë, por edhe favorizon përfshirjen sociale duke promovuar ndërveprimet shoqërore, duke bërë fëmijët të pranishëm dhe me qasje në shërbime publike, gjë që mundëson zbulimin e problemeve sipas nevojës.

Arsimi parashkollor është gjithashtu e rëndësishme për përfshirje sociale të fëmijëve të riatdhesuar, në veçanti me këndvështrim drejt zvogëlimit të pabarazive që prekin fëmijët nga grupet e cënueshme.

Komunitat kanë përgjegjësinë primare në sigurimin që fëmijët e riatdhesuar të kenë qasje në arsim cilësor. Qasja në arsim cilësor për fëmijët e riatdhesuar, veçanërisht fëmijët e cënueshëm, bie në përgjegjësitë e Drejtoratit Komunal për Arsim, të përkrahur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim është

përgjegjëse për informim, koordinim ndër-sektorial, monitorim dhe raportim të gjendjes së fëmijëve të riatdhesuar në kontekst të arsimit. MPB/DRRP përkrahë përmbushjen e të drejtës në arsim të fëmijëve të riatdhesuar duke ofruar përkrahje në identifikimin e fëmijëve, monitorim të progresit dhe koordinimit ndër-sektorial në nivelin qendror.

Të sigurohet që fëmijët e riatdhesuar, të cilët mund të jenë në gjendje të vështirë, për shkak të mosnjohjes së gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe që nuk janë të familjarizuar me sistemin arsimor në Kosovë, regjistrohen në shkollë, marrin edukim cilësor, ndjekin mësimin dhe përfundojnë shkollimin.

MASHTI, DKA-ja dhe institucionet tjera arsimore duhet të kenë konsideratë se të gjitha këto kërkojnë masa specifike.

Identifikimi i fëmijëve që rrezikojnë të mbesin jashtë sistemit arsimor

ZKKK-ja është përgjegjëse për identifikimin e fëmijëve të riatdhesuar që duhet të regjistrohen në sistemin arsimor, përgatit listën fillestare të fëmijëve nga informatat e SMR-së, nivelin e tyre të shkollimit nëse dihet, apo nivelin e përafërt të shkollimit bazuar në moshën e tyre, duke përfshirë ata për parashkollorë. Listën e plotësuar ia procedon Drejtorisë Komunale për Arsim për veprim të mëtejshëm.

Si pjesë e vlerësimit të nevojave që ZKKK-ja e kryen me arritjen e personave të riatdhesuar siç është përshkruar në këtë udhëzues, ZKKK-ja verifikon numrin e fëmijëve dhe nivelin e tyre të shkollimit, gjuhën që flasin dhe sfidat specifike që duhen adresuar (transporti për në shkollë, gjendja socio-ekonomike e familjes, etj.). Ajo përfshin informatat në sistemin e menaxhimit të rastit dhe i kalon ato te Drejtorati Komunal për Arsim.

Gjatë vizitave të rregullta të familjet e riatdhesuara, ZKKK-ja verifikon regjistrimin në shkollë dhe ndjekjen e mësimave nga fëmijët e riatdhesuar. Nëse zbulon se fëmijët nuk janë në shkollë, ajo informon DKA-në për veprime pasuese.

Drejtorët e shkollave janë gjithashtu përgjegjës për identifikimin e nevojave specifike të fëmijëve të riatdhesuar dhe barrierave në ndjekjen e mësimit dhe këshillimin e Drejtoratit Komunal për Arsim, të cilët ndajnë informatat me ZKKK-në.

DKA-ja informon ZKKK-në në baza të rregullta dhe raporton çdo vit tek MASHT-i lidhur me regjistrimin dhe ndjekjen e shkollimit nga fëmijët e riatdhesuar dhe jep llogari për fëmijët e riatdhesuar që nuk janë në shkollë.

5.2.1. Sigurimi i qasjes në shkollë për fëmijët e riatdhesuar

Regjistrimi: DKA-ja, në bashkëpunim me ZKKK-në, punon me drejtorët e shkollave në lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve të riatdhesuar në shkollë, duke pasur parasysh fëmijët pa certifikatë të lindjes apo certifikatë shkollimi, në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Me të arritur në aeroport, zyrtari i MPB-së në aeroport që pranon familjet e riatdhesuara kontrollon dokumentet e shkollimit për personat e riatdhesuar. Ai përfshin informatat në sistemin e menaxhimit të rastit. Në rast se mungojnë dokumentet e shkollimit, zyrtari në aeroport e raporton te DRPR-ja i cili kërkon nga DSHAM, të siguroj dokumentacion tek vendi dërgues.

DKA-ja, në bashkëpunim me ZKKK-në, përkrahë përfshirjen e fëmijëve të riatdhesuar në strukturat parashkollore.

Kurset e gjuhës

ZKKK-ja këshillon Drejtoratin Komunal për Arsim dhe Koordinatorin Rajonal të MPB-së lidhur me nevojën për kurse të gjuhës bazuar në vlerësimin e nevojave.

Drejtoritë Komunale për Arsim, në koordinim me ZKKK-në, organizojnë kurse të gjuhës për fëmijët e riatdhesuar që nuk flasin gjuhën me të cilën mësohet në shkollë dhe mësim plotësues me përkrahjen nga MASHT. Ato infomojnë MASHT-in lidhur me nevojat e tyre për kurse gjuhe. MASHT-i, në koordinim me Koordinatorin Rajonal të MPB-së dhe zyrtarin përgjegjës për arsim në kuader të DRPR-së, organizon kurse të gjuhës dhe mësimin plotësues nëpër komuna sipas nevojës.

MASHT-i siguron planprogramet, materialin pedagogjik, përzgjedhjen dhe trajnimin e mësimdhënësve.

Transporti

Komunat organizojnë transportin relevant për fëmijët e riatdhesuar në mënyrë që ata të ndjekin kurset e gjuhës dhe mësimin plotësues.

Programet e veçanta për regjistrimin dhe mbajtjen e fëmijëve në shkollë

DKA-ja cakton programe të veçanta për regjistrimin dhe mbajtjen e fëmijëve të riatdhesuar në shkolla, duke përfshirë parashkollorët. Këto programe fokusohen ndër të tjera në vizitë të drejtpërdrejtë në vend tek familjet dhe adresimin e shkaqeve rrënjësore për mospërfshirje apo braktisje nga shkolla. Programet e tilla kombinohen me programet ekzistuese për regjistrim dhe mosbraktisje.

Në këtë mënyrë, ata punojnë bashkë me prindërit, organizatat e komunitetit dhe OJQ-të tjera relevante. Ata mund të delegojnë implementimin e programeve të tilla apo të bëjnë partneritet me OJQ-të përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit dhe thirrjes së hapur për projekt propozime.

DKA-ja, në bashkëpunim me ZKKK-në, organizojnë konsulta me prindërit, posaçërisht me ata të grupeve të cënueshme, së paku një herë në vit lidhur me statusin e procesit të riintegritimit në lidhje me arsimin. Rezultatet ndahen me MASHT-in dhe MPB-në/DRRP si pjesë e procesit të raportimit.

5.2.2. Ofrimi i arsimit cilësor

MASHT-i përkujdeset që aktivitetet e rregullta trajnuese dhe/ose trajnimet specifike të mësimdhënësve që punojnë në zonat me numër të konsiderueshëm të fëmijëve të rrezikuar nga mospërfshirja, në veçanti fëmijë të riatdhesuar dhe fëmijë nga grupe tjera të cënueshme, të përfshijnë module lidhur me përvojën e veçantë të atyre dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këta fëmijë dhe mënyrat për t'i trajtuar.

MASHT-i promovon zhvillimin e materialit pedagogjik për mësimdhënësit që përfshijnë module lidhur me përvojën e veçantë, sfidat me të cilat ballafaqohen fëmijët e riatdhesuar, posaçërisht ata nga grupet e cënueshme, dhe mënyrat për t'i trajtuar ato.

MASHT-i përkrah hulumtimin, analizën dhe promovimin e praktikave të mira për ofrimin e arsimit cilësor për fëmijët e riatdhesuar përmes buletineve dhe botimeve të rregullta për mësimdhënësit, punëtorët social dhe profesionistët tjerë edukativ.

Financimi: MPB-ja/DRRP alokon buxhetin relevant MASHT-it për edukimin e fëmijëve të riatdhesuar nga Fondi i Riatdhesimit dhe Riintegritit, me alokime shitesë për fëmijët nga grupet e cënueshme.

MASHT-i mund ose të implementojë programe apo të alokojë fonde komunave nga Fondi i Riintegritit për përkrahje të riintegritit të fëmijëve të riatdhesuar. Ajo gjithashtu përfshinë gjendjen e fëmijëve të riatdhesuar në programet e përgjithshme që kanë për qëllim realizimin e të drejtës në arsim për fëmijët e cënueshëm, duke marrë në konsideratë numrin e fëmijëve të riatdhesuar në të gjitha komunat.

MASHT-i monitoron mbarvajtjen e kurseve të gjuhës dhe mësimin plotësues dhe i raporton MPB-së/DRRP-së.

5.3.Shëndeti

Akterët kryesorë: Ministria e Shëndetësisë/Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale/QKMF, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), Ministria e Punëve të Brendshme(MPB/DRRP).

Qasja në shëndetësi - Informimi

Të gjithë aktorët që vijnë në kontakt me personat e riatdhesuar kanë përgjegjësi të ofrojnë informata lidhur me sistemin shëndetësor në Kosovë dhe mënyrën e qasjes në të.

MPB/DRRP perkujdeset për sigurimin e fletushkave informuese që do të jenë në dispozicion për personat e riatdhesuar, të cilat përmbajnë informata lidhur me sistemin shëndetësor në Kosovë dhe mënyrën e qasjes në të. Ajo përfshin informata specifike me komunën (apo drejtorinë) me adresë dhe informata kontaktuese për shërbimet shëndetësore. Fletushka gjithashtu përmban informata bazike lidhur me rëndësinë e imunizimit, higjienës dhe sëmundjeve që mund të jenë më të shpeshta në Kosovë sesa në shumicën e vendeve dërguese. Informatat janë në dispozicion edhe në versionet e favorshme për fëmijët.

Me të arritur, ZKKK-ja informon personat e riatdhesuar lidhur me qasjen në shëndetësi në nivelin komunal.

Si pjesë e vlerësimit të nevojave, ZKKK-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, vlerëson nevojat e mundshme për kujdes shëndetësor për personat e riatdhesuar, me vlerësim ndaras për fëmijët.

Vizitat në teren

ZKKK-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, organizon vizita të profesionistëve mjekësorë tek familjet me fëmijë për të shikuar gjendjen e tyre shëndetësore dhe për të ofruar trajtim sipas nevojës, së paku çdo 3 muaj. Vëmendje e veçantë do të kushtohet familjeve të cënueshme me fëmijë, ku do të realizohen vizita me prioritet.

Zhvillimi i përkrahjes psiko-sociale

MSH-ja, në bashkëpunim me MASHT-in dhe MPMS-në, përkrahin zhvillimin e programeve trajnuese psikologjike për profesionistët shëndetësorë dhe të tjerë që merren me persona të riatdhesuar, me specializim në përkrahje psikologjike të fëmijëve.

Sistemi i menaxhimit të rasteve shëndetësore

ZKKK regjistron informatat lidhur me gjendjen shëndetësore të personave të riatdhesuar në sistemin e menaxhimit të rastit.

Informatat lidhur me shëndetin të përfshira në sistemin e menaxhimit të rastit janë të qasshme vetëm nga profesionistët shëndetësorë në kushte konfidencialiteti.

5.4.Regjistrimi Civil

Akterët kryesorë: MPB-ja/Angjencia e Regjistrimit Civil, Komunitat(Zyrat e Gjendjes Civile), DRPR-ja, DSHAM-i dhe ZKKK-ja

Identifikimi i fëmijëve pa certifikatë lindjeje

Me të pranuar listën e personave të riatdhesuar nga vendi dërgues, DSHAM identifikon fëmijët e lindur jashtë Kosovës dhe i bën kërkesë për certifikatë të lindjes vendit dërgues. Kërkesa duhet të përfshihet në listën e dokumenteve të cekura në këtë Udhëzues.

Me të arritur në aeroport, zyrtari i MPB-së në aeroport që pranon familjet e riatdhesuara kontrollon dokumentet e gjendjes civile për personat e riatdhesuar, në veçanti posedimin e certifikatave të lindjes për fëmijët e lindur jashtë Kosovës, sipas këtij Udhëzuesi. Ai përfshin informatat në sistemin e menaxhimit të rastit. Në rast se mungojnë certifikatat e lindjes për fëmijët e lindur jashtë, zyrtari në aeroport e raporton te DRPR-ja i cili kërkon nga DSHAM, të siguroj dokumentacion tek vendi dërgues apo tek vendi i lindjes së fëmijës.

Me të arritur në komunë dhe si pjesë e vlerësimit të nevojave, ZKKK-ja kontrollon dokumentet e gjendjes civile për personat e riatdhesuar, në veçanti posedimin e certifikatave të lindjes për fëmijët e riatdhesuar. Nëse nuk ka dokumentacion në dispozicion, ZKKK-ja i bën kërkesë në DRPR përmes Koordinatorit Rajonal në mënyrë që të zgjidh rastin dhe t'u ofroj fëmijëve dokumentacionin e nevojshëm.

Sigurimi i regjistrimit të vonuar për fëmijët e riatdhesuar

Sipas legjislacionit në fuqi, zyrat e gjendjes civile në komuna ofrojnë dokumentet e gjendjes civile për personat e riatdhesuar. Regjistrimi civil është falas për personat e riatdhesuar për së paku 12 muaj, me mundësi të zgjatjes edhe për 6 muaj tjerë në rrethana të jashtëzakonshme, posaçërisht kur familja identifikohet si e cenueshme sipas Rregullores QRK 20/2013.

Personat e riatdhesuar kanë qasje në ngjarjet “muaji i regjistrimit falas të lindjes” të organizuara nga komunitat.

Qendrat për pajisje me dokumentenë nivelin komunal bëjnë të gjitha përpjekjet për të lehtësuar dhënien e dokumenteve personave të riatdhesuar në harmoni me legjislacionin ekzistues.

Shtrirja e shërbimeve deri te familjet

ZKKK-ja është përgjegjëse që të kontrollojë që fëmijët e riatdhesuar, posaçërisht fëmijët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptian, kanë dokumentacion të gjendjes civile. ZKKK-ja regjistron në bazën e të dhënave të menaxhimit të rastit mungesën e dokumentacionit dhe e informon koordinatorin rajonal të DRPR-së.

ZKKK-ja, në koordinim me koordinatorin rajonal dhe Zyrën komunale të gjendjes civile, viziton familjet për të promovuar regjistrimin civil për fëmijët e riatdhesuar, posaçërisht fëmijët nga familjet e cënueshme.

Në raste të veçanta, regjistrimi në librat e gjendjes civile mund të bëhet në vendndodhjen e personit të riatdhesuar.

ZKKK-ja informon familjet lidhur me hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar dokumentacion civil për të gjithë anëtarët e familjes, posaçërisht certifikatat e lindjes për fëmijët. Ajo informon familjet përkatëse lidhur me ngjarjet e veçanta që mbahen në komunë për regjistrim civil.

Fletushka informative për mënyrën e regjistrimit të fëmijëve dhe përfitimet nga regjistrimi i lindjes shpërndahen nga ZKKK-ja.

5.5.Mirëqenia sociale dhe punësimi

Akterët kryesorë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Departamenti për Punë dhe Punësim, Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare), Qendra Rajonale të Punësimit, Qendrat për Aftësim Profesional, Komunitet, (Qendrat për Punë Sociale (QPS), Zyrat Komunale të Punësimit, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK).

5.5.1.Asistenca sociale dhe qasja në beneficione

Personat e riatdhesuar kanë qasje në beneficionet dhe asistencën sociale që është në dispozicion për të gjithë qytetarët e RKS-së. DRPR përfshin në fletushkat informuese për personat e riatdhesuar informatat lidhur me beneficione të qëndrueshme në dispozicion, kushtet dhe mënyrat për të aplikuar për to.

ZKKK-ja informon personat e riatdhesuar lidhur me procesin e aplikimit për beneficione dhe asistencë sociale, si dhe përkrah të riatdhesuarit sipas nevojës, në mbushjen e formularëve dhe dorëzimin e tyre tek shërbimet relevante sociale. ZKKK-ja regjistron informatat në SMR.

Sigurimi i mirëqenies sociale përkrah riintegrimin e familjeve të riatdhesuara në nevojë. Programet më të rëndësishme të mirëqenies sociale janë: skema e pensionit bazik, skema e pensionit invalidor, skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe skema e ndihmës sociale. Të gjitha skemat menaxhohen nga MPMS e cila duhet të sigurojë përfshirjen e të gjithë personave të riatdhesuar, që gëzojnë këtë të drejtë, në skemat e lartcekura.

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi

ZKKK-ja në bashkëpunim me punëtorët socialë të QPS-ve viziton rregullisht (së paku 4 herë në vit) familjet e riatdhesuara me fëmijë. ZKKK-ja regjistron gjendjen në SMR dhe njofton DRPR-në përmes Koordinatorëve Rajonal për veprimet e mëtejme sipas nevojës.

Në rast kur fëmijët rrezikohen të mbesin pa shtëpi, në varfëri të skajshme, të neglizhuar, në rrezik të të qenit të neglizhuar, apo viktimë të dhunës e abuzimit, ky rast i referohet QPS-së në nivel lokal për hapa të mëtejshëm.

Task Forca multi-disiplinore për fëmijët në rrezik nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi brenda QPS-së ekzaminon rastin dhe vendos lidhur me veprimet pasuese. Në këtë

rast zyrtari komunal nga ZKKK-ja merr pjesë në Task Forcë. QPS-ja ndërmerr veprimet e domosdoshme sipas mandatit të saj. Mund të bëjë rekomandime specifike për qasje në beneficione për personat e riatdhesuar, duke përfshirë “asistencën e rastit” të paraparë në Rregulloren 20/2013.

ZKKK-ja regjistron rezultatet e Task Forcës në SMR. MPB-ja/DRRP përkrahë personelin e QPS-së në lidhje me sfidat specifike me të cilat ballafaqohen fëmijët e riatdhesuar, në veçanti fëmijët nga grupet e cënueshme.

ZKKK-ja dhe QPS-ja, mund të lidhin partneritet me OJQ-të relevante për ofrimin e përkrahjes adekuate për familjet e riatdhesuara përmes procedurës së thirrjes së hapur përprojekt propozime.

Zhvillimi i mundësive të punësimit për personat e riatdhesuar: Departamenti për Punë dhe Punësim pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS/DPP) bën vlerësim të gjendjes së punësimit të personave të riatdhesuar dhe aftësive të tyre profesionale në mënyrë që t'i përfshijë ata në strategjitë e punësimit.

MPMS/DPP përkrahë zhvillimin e programeve trajnuese profesionale për përfshirjen e personave të riatdhesuar në tregun e punës. Ajo zhvillon partneritet me sektorin privat në mënyrë që të promovoj punësimin e personave të riatdhesuar në bashkpunim me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare relevante.

5.5.2. Integrimi ekonomik përmes aftësimit profesional, përkrahjes në punësim dhe vetëpunësimit

Akterët kryesorë: MPMS/DPP(Departamenti për Punë dhe Punësim), Komunitat/ZKP (Zyra Komunitet e Punësimit), QAP (Qendrat e Aftësimit Profesional), ZKKK-ja (Zyra Komunitet për Kthim dhe Komunitete) , DRPR (Departamenti për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar)

Informimi

Fletushkat e përpiluara nga DRPR dhe partnerët implementues, për personat e riatdhesuar, ofrojnë informata lidhur me mundësitë e përkrahjes së integrimit ekonomik në Kosovë dhe mënyrat e qasjes në të.

ZKKK-ja e informon personin e riatdhesuar për mundësitë e përkrahjes me qëllim të integrimit të suksesshëm ekonomik të tij dhe e delegon në ZKP bashkë me informatat përcjellëse dhe formularin e plotësuar.

ZKP-ja përgjatë këshillimit me të riatdhesuarin, definon profilin e tij dhe si rezultat i ofron skemën përkatëse të përkrahjes si:

- Aftësim profesional (përmes QAP, Bartësve tjerë të AP, apo trajnim në punë tek një kompani- AP;
- Praktikë në Punë-PP;
- Ndërmjetësim të drejtpërsëdrejti në Punësim- NDP.

ZKP-ja, varësisht prej profilizimit, realizon aktivitetet vetanake apo i delegon tek bartësit e aktivitetit përkatës.

Masat Aktive të Integrimit Ekonomik

Kriteret e përfshirjes së personave të riatdhesuar në masat aktive të punësimit janë të përcaktuara në Rregullorën QRK Nr. 20/2013. ZKP-ja, në rastet kur i riatdhesuari është profilizuar për skemat aktive të punësimit “Trajnim në Punë”, “Praktikë në Punë”, apo “Ndërmjetësim në Punësim” (Skema e subvencionimit të pagës), identifikon kompaninë dhe i definon të gjitha hapat dhe kushtet e realizimit të aktivitetit përkatës, duke nënkuptuar edhe përkrahjen financiare nga Programi i Riintegritimit dhe kompania. Identifikimi i kompanisë, mund të bëhet edhe nga vetë i riatdhesuari gjatë apo pas procesit të këshillimit.

ZKKK-ja informon personat e riatdhesuar për mundësitë e përkrahjes përmes vetëpunësimit gjegjësisht themelimit të biznesit. Në rast të shprehjes së interesit të riatdhesuarit për këtë formë të përkrahjes, ZKKK-ja ia ofron atij formularin për themelim biznesi dhe e delegon për ndihmë dhe përkrahje në ZKP.

ZKP vlerëson parakushtet të cilat i posedon i riatdhesuari për Themelim të Biznesit e trajnon atë, pastaj në përfundim e vlerëson arsyeshmerinë ekonomike të themelimit, si dhe i rekomandon Komisionit Qendror për Riintegrim për aprovim/mos aprovim.

I riatdhesuari i cili është përfitues i financimit të biznesit ndihmohet dhe mbështetet për themelimin dhe zhvillimin e biznesit nga ZKP e cila e monitoron dhe e vlerëson periodikisht implementimin e biznesit.

Përkrahja e personave të riatdhesuar për qasje në tregun e punës

Si pjesë e vlerësimit të nevojave të përshkruara në këtë udhëzues, ZKKK-ja vlerëson gjendjen e punësimit dhe aftësitë profesionale të personave të riatdhesuar.

Ajo informon personat e riatdhesuar lidhur me mundësitë ekzistuese për trajnime profesionale dhe i drejton ata në Qendrën për Trajnime Profesionale më të afërt. Ajo i drejton personat e riatdhesuar tek zyrat komunale për punësim.

Zyrat komunale për punësim shqyrtojnë aftësitë e personave të riatdhesuar dhe identifikojnë profilin(et) e tyre profesionale në pajtim me listën e zhvilluar nga MPMS-ja. Ata këshillojnë personat e riatdhesuar lidhur me strategjitë e gjetjes së punësimit. Ata përfshijnë personat e riatdhesuar në programet për promovim të punësimit të synuar për popullatën e përgjithshme.

Në mënyrë që t’u qasen beneficioneve të asistencës dhe në rast se një gjë e tillë nuk pamundësohet për shkak të rrethanave të veçanta, personat e riatdhesuar janë të obliguar të regjistrohen në Zyrën Komunale për Punësim dhe të intervistohen nga kjo zyrë me qëllim përcaktimin e aftësive të tyre profesionale brenda vitit të parë të arritjes në komunë.

Kapitulli VI. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve

Akterët kryesorë: Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar), (Departamenti i Teknologjisë Informative), Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Sistemi për Menaxhimin e Rasteve është sistem elektronik i cili administrohet nga MPB/DRPR në të cilin regjistrohen, ruhen, procedohen dhe arkivohen kërkesat dhe të dhënat tjera relevante lidhur me personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre. Përmes SMR-së menaxhohet në tërësi procesi i riintegrit të personave të riatdhesuar nga momenti i hyrjes në Kosovë deri në mbylljen e rastit, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Të dhënat e personave të riatdhesuar trajtohen në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Të dhënat regjistrohen në SMR nga:

- Zyrtarët e Pritjes së DRPR-së në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës;
- ZKKK-ja;
- Zyrtarët përgjegjes të DRPR-se në rast nevojë;
- Organizatat që mbështesin riintegrimin në Kosovë;
- Institucionet relevante të riintegrit.

Akterët e përfshirë në çështjet që kanë të bëjnë me personat e riatdhesuar mbajnë shënime për aktivitetet e kryera duke përfshirë vizitat e realizuara. Drejtoratet komunale i komunikojnë informatat ZKKK-së e cila i regjistron këto të dhëna në SMR.

MPB-ja organizon dhe ofron trajnime për përdorimin e SMR-së për të gjithë aktorët që merren me regjistrimin e të dhënave. Koordinatorët rajonal të DRPR-së përfitojnë trajnime shtesë dhe i përkrahin komunat në përdorimin e SMR-së

Nga SMR-ja deri në veprimet e integruara

SMR-ja mundëson evidentimin e çështjeve që kërkojnë vëmendje dhe veprime konkrete. Mundëson monitorimin e adresimit të nevojave, veprimeve të ndërmarrura dhe rezultatet e atyre veprimeve.

Kur rasti kërkon vëmendje specifike, ZKKK-ja në bashkëpunim me QPMS dhe drejtoritë tjera relevante komunale trajton dhe monitoron nga afër këto raste. DRPR përmes Koordinatorit Rajonal përkrah ZKKK-të në rast nevojë.

Veprimet e ndërmarra regjistrohen në SMR. DRPR-ja mbikëqyrë në vazhdimësi veprimet e ndërmarra për ndihmë dhe mbështetje të personave të riatdhesuar që kërkojnë vëmendje specifike.

Për veprimet për të cilat nevojitet intervenim në nivelin qendror, MPB/DRPR-ja koordinohet me ministritë relevante. Për veprimet e nevojshme në nivelin komunal, koordinatorët rajonal përcjellin rastin me ZKKK-në dhe i raportojnë DRPR-së.

Në kuader të DRPR-së emërohet zyrtari përgjegjës për menaxhimin e rastit.

Menaxhimi i të dhënave dhe analizat

Analiza e të dhënave nga SMR-ja përdoret për planifikimin e politikave të riintegritimit. Në veçanti, planifikimi për nevojat financiare bazohet kryesisht në të dhënat e viteve paraprake të raportuara në SMR. DRPR-ja është përgjegjëse për analizimin e të dhënave së paku një herë në vit. Në këtë rast merret në konsideratë bashkëpunimi me Agjencinë e Statistikave, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të relevante.

Kapitulli VII. Modalitetet e koordinimit ndërmjet akterëve në nivelin qendror dhe lokal

Grupi ndërinstitutional i riintegritimit si organ përgjegjës për vlerësimin e zbatimit të politikave të riintegritimit mban takime të rregullta ku diskutohen progresi, sfidat dhe mënyrat e adresimit të tyre. Grupi ndërinstitutional kryesohet nga ministri/zv.ministri i MPB-së dhe përbëhet nga ministrat e ministrive relevante dhe kryetarët e komunave. Në këto takime marrin pjesë edhe organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të relevante. Grupi ndërinstitutional takohet së paku 2 herë në vit. Në këto takime mund të ftohen edhe donatorët dhe përfaqësues të vendeve kthyesë. Në këto takime DRPR luan rolin e sekretariatit.

7.1. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin qendror

MPB/DRPR është përgjegjëse për koordinimin e riintegritimit të personave të riatdhesuar. Ministrinë relevante caktojnë nga një zyrtar përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të riintegritimit i cili bashkëpunon ngushtë me MPB/DRPR.

DRPR mban takime të rregullta çdo tre muaj me akterët relevantë duke përfshirë Organizatat Ndërkombëtare dhe OJQ-të relevante, me qëllim të vlerësimit të progresit të politikave të riintegritimit të personave të riatdhesuar, të vlerësojë rezultatet e arritura, të shqyrtojë sfidat për adresim dhe të identifikojë boshllëqet dhe strategjitë për përmirësim.

Në mënyrë specifike DRPR:

- (1) Rishikon statusin e integritimit të personave të riatdhesuar me fokus në fëmijët, dhe grupet e cënueshme.
- (2) Zhvillon plan të integruar vjetor për zbatimin e Rregullores QRK 20/2013;
- (3) Në mënyrë periodike rishikon zbatimin e planit të punës dhe veprimet e ndërmarra;
- (4) Rishikon nivelin e shpenzimeve dhe përdorimin aktual të Fondit për Riintegrim nga të gjitha ministrinë që kanë projekte të financuara nga ky fond;
- (5) Rishikon dhe vlerëson rezultatet e politikave;
- (6) Vlerëson nevojat e koordinimit ndërmjet ministrive;
- (7) Promovon integrimin e çështjeve që kanë të bëjnë me personat e riatdhesuar në të gjitha fushat e politikë bërjes;
- (8) Rishikon analizat e të dhënave nga SMR-ja;
- (9) Diskuton funksionimin e SMR-së dhe mënyrat për avancimin e tij;
- (10) Diskuton dhe ndanë me të tjerët praktikën e mirë;
- (11) Ekzaminon rastet e vështira të riintegritimit.

Pas çdo takimi të rregullt, DRPR-ja nxjerr raport të progresit lidhur me implementimin e procesit të riintegritimit, thekson sfidat dhe nxjerr rekomandimet për avancimin e riintegritimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Raporti, duke përfshirë rekomandimet, i shpërndahet akterëve relevantë.

Vëmendje e duhur i kushtohet përfaqësimit të interesave të fëmijëve të riatdhesuar dhe personave të cënueshëm siç përcaktohet në Rregulloren QRK 20/2013. Akterët e jashtëm prezantojnë pikëpamjet e tyre tek MPB/DRPR dhe ofrojnë këshilla për mënyrat e avancimit të politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

7.2. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin lokal

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim është përgjegjëse për koordinimin e riintegrit të personave të riatdhesuar në nivel lokal. Ajo është pika kryesore kontaktuese me personat e riatdhesuar. Ajo i referon rastet tek drejtoritë përkatëse për veprim dhe monitoron e përcjell veprimet e ndërmarra.

Në pajtueshmëri me Rregulloren 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, të gjithë zyrtarët e komunës janë të obliguar të bashkëpunojnë me ZKKK-në gjatë kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së përgjegjësisë së saj me qëllim të lehtësimit të riintegrit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar.

Përveç shqyrtimit të kërkesave individuale, ZKKK në bashkpunim me Komisionin Komunal për Riintegrim mbajnë takime të rregullta çdo tre muaj në mënyrë që të vlerësojë progresin në riintegrim të personave të riatdhesuar në komunë, të vlerësojë rezultatet e arritura, të shqyrtojë sfidat që duhen adresuar dhe të identifikojë boshllëqet dhe masat për përmirsim. ZKKK-ja i kryeson këto takime.

Në mënyrë specifike ZKKK dhe Komisioni Komunal për Riintegrim:

- (1) Rishikon statusin e riintegrit të personave të riatdhesuar, posaçërisht fëmijëve dhe grupeve të cënueshme, brenda komunës;
- (2) Analizon të dhënat nga SMR-ja dhe diskuton për çështjet kryesore;
- (3) Rishikon progresin e riintegrit në sektorët kyçe (banimi, shëndeti, arsimi, regjistrimi civil, punësimi dhe mirëqenia sociale).
- (4) Vlerëson nevojat specifike për përkrahje nga niveli qendror.

Pas çdo takimi të veçantë, KKR-ja nxjerr raport progresi në lidhje me implementimin e procesit të riintegrit, thekson sfidat dhe nxjerr rekomandime për avancimin e riintegrit afatgjatë të personave të riatdhesuar. Raporti, bashkë me rekomandimet, i dorëzohet DRPR-së përmes Koordinatorit Rajonal.

Së paku një herë në vit ZKKK në bashkëpunim me KKR-në mban takime me OJQ-të relevante, organizatat ndërkombëtare që punojnë me dhe për persona të riatdhesuar dhe përfaqësues të personave të riatdhesuar. Vëmendje e duhur i kushtohet përfaqësimit të interesave të fëmijëve të riatdhesuar dhe personave të cënueshëm për shkak të kriterëve të cekura në Rregulloren QRK 20/2013. Akterët e jashtëm paraqesin pikëpamjet e tyre tek ZKKK-ja dhe këshillojnë lidhur me adresimin e sfidave të identifikuara.

ZKKK-ja i dorëzon Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal raporte vjetore lidhur me aktivitetet e riintegrit dhe nevojat për planifikim.

Kuvendi Komunal organizon takim të veçantë çdo vit në dhjetor për të diskutuar raportin dhe progresin e arritur në riintegrimin e personave të riatdhesuar, në veçanti personave të cënueshëm. Takimi është publik sipas Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. OJQ-të relevante, organizatat ndërkombëtare që punojnë për dhe me personat e riatdhesuar dhe përfaqësuesit e personave ftohen për të marrë pjesë përmes thirrjes publike.

7.3. Koordinimi vertikal

Komunat kanë përgjegjësinë kryesore për riintegrim afatgjatë të personave të riatdhesuar, siç parashihet në Rregulloren QRK Nr.20/2013.

Për të siguruar që komunat kanë mjete për të përmbushur rolin e tyre, MPB-ja dhe ministritë tjera relevante u ofrojnë komunave përkrahjen adekuate teknike, financiare dhe koordinuese.

Përkrahje e përgjithshme e oruar nga MPB/DRPR-ja për komunat përfshinë:

- (1) Sigurimin e udhëzuesve lidhur me obligimet e komunave sipas Rregullores QRK 20/2013 dhe Strategjisë Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar brenda tre muajsh pas aprovimit të standardeve të reja, akteve ligjore dhe dokumenteve tjera të politikave.
- (2) Sigurimin e formularëve model për dorëzimin e kërkesave për përfitim në secilin sektor brenda tre muajsh pas aprovimit të standardeve të reja, akteve ligjore dhe dokumenteve tjera të politikave.
- (3) Sigurimin e dokumenteve model për zhvillimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit me organizatat partnere brenda tre muajsh pas aprovimit të standardeve të reja, akteve ligjore dhe dokumenteve tjera të politikave.
- (4) Sigurimin e trajnimeve për personelin e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim për të shqyrtuar kornizat legjislative dhe të politikave, për të vlerësuar trendet dhe për të diskutuar sfidat e ZKKK-së në punën ditore dhe mënyrat për të adresuar ato.
- (5) Ofrimi i fletushkave, broshurave dhe materialit tjetër informues për personat e riatdhesuar në gjuhë të ndryshme, duke dhënë hollësi për beneficionet që u takojnë personave të riatdhesuar, si t'u qasen atyre si dhe informata gjithëpërfshirëse lidhur me shërbimet publike në Kosovë në sektorë të ndryshëm dhe mënyrën e qasjes në to. Materiali informues i favorshëm për fëmijë ofrohet gjithashtu. Materialet e tilla rishikohen çdo vit në mënyrë që të sigurohet që informatat janë të azhurnuara me zhvillimet e fundit.
- (6) Sigurimi i formave standarde për dorëzim të raportit të progresit dhe raporteve vjetore nga ZKKK-ja.
- (7) Promovimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave që ballafaqohen me sfida të njëjta në mënyrë që të grumbullohen resurset për adresimin e çështjeve të riintegrit me të cilat ballafaqohen personat e riatdhesuar, për shembull ofrimin e shërbimeve të këshillimit, kurseve të gjuhës apo trajnimeve profesionale. Koordinimi kryesisht ndodh përmes Koordinatorit Rajonal të MPB-së të cilët identifikojnë nevojat në baza vjetore dhe lehtësojnë bashkëpunimin ndërmjet komunave.

Përkrahja specifike e ofruar nga ministritë relevante për komunat përfshijnë:

- (1) Asistencë teknike për zbatimin e politikave në fushat përkatëse.
- (2) Ministritë e përfshira përkrahin komunat në identifikimin e partnerëve adekuat për zbatimin e politikave përkatëse që ndërlidhen me riintegrim të qëndrueshëm.

Komunat ndërmarrin veprime për të kërkuar përkrahjen e nevojshme nga niveli qendror. MAPL në ndihmon dhe mbështet MPB/DRPR-në hartimin e planeve të trajnimit dhe organizimin e tyre për ngritjen e kapaciteteve nivelin lokal.

Komunat në baza të rregullta periodike i dërgojnë MPB/DRPR raporte me të dhënat për personat e riatdhesuar nga SMR-ja dhe nga burimet tjera relevante. Raportet pasqyrojnë qasjen e komunave ndaj personave të riatdhesuar, në veçanti fëmijëve dhe grupeve të cënueshme. MPB/DRPR përmbledhë raportet dhe i ndanë ato me ministritë relevante.

Kapitulli VIII. Menaxhimi i fondeve

Akter kryesor: Ministria e Punëve të Brendshme

Fondi i Riintegritimit alokohet çdo vit si pjesë e buxhetit shtetëror. Shpenzimi i tij bëhet në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Rregulloret mbi Thesarin 01 dhe 02 dhe Urdhëresat Administrative tjera të lëshuara nga Ministria e Financave.

8.1. Alokimi i buxhetit shtetëror për Fondin e Riintegritimit

Si pjesë e përgatitjes së rregullt të buxhetit, DRPR paraqet kërkesat për alokim nga buxheti shtetëror si pjesë e buxhetit vjetor të MPB. Buxheti i riintegritimit po ashtu është pjesë e KASH

Vlerësimi i nevojave financiare bazohet kryesisht në numrin e personave të riatdhesuar gjatë tri viteve të fundit, duke marrë në konsideratë nevojat shtesë për fëmijët dhe grupet tjera të cenueshme, si dhe raportet nga komunat dhe nevojat nga ministritë relevante.

Financimi i projekteve nga programi i riintegritimit për ofrimin e shërbimeve për riintegrim të qëndrueshëm për personat të riatdhesuar

Një pjesë e fondit mund të ndahet për ministritë relevante apo komunat, si dhe për projektet e organizatave joqeveritare të regjistruara në Kosovë dhe për projektet e organizatave ndërkombëtare përmes thirrjes së hapur për aplikim. Financimi i projekteve përmes thirrjes së hapur për aplikim rregullohet me legjislacionin përkatës në fuqi.

8.2. Monitorimi i shfrytëzimit të fondeve

Fondi i Riintegritimit monitorohet nga DRPR përmes raporteve periodike për shfrytëzimin e fondit nga të gjithë akterët që zbatojnë projekte të financuara nga programi i riintegritimit. Raporti përfshinë shumën e shpenzuar, shfrytëzimin konkret dhe rezultatet e arritura, si dhe pengesat e mundshme në harmoni me rregullat e transparencës dhe legjislacionin tjetër relevant. Raporti dorëzohet çdo vit në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

MPB/DRPR zhvillon forma standarde për raportim të shfrytëzimit të fondeve nga ministritë, komunat, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Fondi i riintegritimit i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në harmoni me legjislacionin në fuqi.

MPB/DRPR nxjerr raport publik vjetor lidhur me statusin e shpenzimeve dhe përdorimin e mjeteve nga programi i riintegritimit. Raporti është publik dhe është i disponueshëm në ueb faqen e MPB-së.

Kapitulli IX: Monitorimi dhe llogaridhënia

9.1. Monitorimi i progresit

Përdorimi i sistemit të menaxhimit të rastit

Sistemi për menaxhimin e rasteve (SMR) është mjeti kryesor monitorues. Ky sistem ofron informata të përditësuara kualitative dhe kuantitative lidhur me numrin dhe gjendjen e personave të riatdhesuar. Të dhënat analizohen siç është përshkruar në këtë udhëzues.

Dorëzimi i raporteve dhe transparencë

MPB/DRPR në fund të çdo viti nxjerr raport vjetor të progresit lidhur me riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe shfrytëzimin e fondeve nga programi i riintegritimit i cili publikohet në ueb faqen e MPB. Raporti pasqyron aktivitetet e të gjithë akterëve relevantë, të cilët ndihmojnë dhe e mbështesin riintegrimin e personave të riatdhesuar. Po ashtu raporte periodike i dorëzohen Komisionit Evropian dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare.

Rishikimi i mekanizmave monitorues

Si pjesë e mandatit të tyre për monitorimin e politikave, DRPR, ZKKK dhe Komisioni Komunal për Riintegrim rishikojnë rregullisht progresin e arritur në shpenzime, progresin në implementim, të arriturat kryesore dhe sfidat.

Progresi monitorohet bazuar në planin vjetor të punës në nivelin komunal dhe atë qendror.

9.2. Llogaridhënia

9.2.1. Mjetet juridike për realizimin e të drejtave për personat e riatdhesuar

Komisioni për Ankesa

Rregullorja QRK Nr. 20/2013 parasheh themelimin e Komisionit për Ankesa, i cili shqyrton ankesat e personave të riatdhesuar kërkesat e të cilëve nuk janë aprovuar nga KQR apo KKR. Komisioni për Ankesa themelohet prej Qeverisë, dhe vepron si trup i pavarur. Ankesat duhet të parashtrohen brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit të kontestuar. ZKKK-ja i informon dhe iu ofron asistencë personave të riatdhesuar në parashtrimin e ankesës. Ankesat dorëzohen në ZKKK e cila përmes Koordinatorëve Rajonal i dorëzon në DRPR për procedim tek Komisioni i Ankesave brenda 2 (dy) ditëve nga pranimi i tyre. Komisioni për Ankesa shqyrton ankesat brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankesës. MPB-ja harton PSO të cilat përshkruajnë në detaje funksionimin e Komisionit për Ankesa.

Konflikti administrativ kundër vendimit të Komisionit për Ankesa:

ZKKK-ja informon personat e riatdhesuar lidhur me procedurat kundër vendimit të Komisionit për Ankesa.

Ombudspersoni

Ombudspersoni mund të rishikojë ankesat e dorëzuara nga personat e riatdhesuar dhe të ndërmjetësojë me autoritetet publike në gjetjen e zgjedhjes. Gjatë rishikimit të ankesave, vëmendje e veçantë i kushtohet interesave më të mira për fëmijën dhe nevojave të grupeve të cenueshme.

Ne harmoni me mandatin e Ombudspersonit, me qëllim të lehtësimit të zgjedhjeve për raste specifike, Ombudspersoni mund të kërkojë qasje në dokumentet e shtetit kthyes në suaza të bashkëpunimit me ombudspersonin e atij shteti.

Personat e riatdhesuar duhet të jenë të informuar përmes fletushkave informuese lidhur me mjetet juridike që janë në dispozicion dhe mënyrën e qasjes në to.

MPB/DRPR merr në konsiderat rekomandimet e Ombudspersonit të prezantuara në raportet vjetore, që ndërlidhen me qështjet e riintegritimit.

9.2.2. Llogaridhënia e akterëve

Detyrat e raportimit

Nga të gjitha palët e interesit të cilat kanë përfituar financim të projekteve nga Fondi për Riintegrim kërkohet që të dërgojnë raporte lidhur me shfrytëzimin e fondeve së paku çdo 6 muaj. Raportet dorëzohen në MPB/DRPR si përgjegjëse për menaxhimin e fondit/programit të riintegritimit.

Koordinatorët rajonal monitorojnë përmbushjen e përgjegjësisë nga komunat në pajtueshmëri me Rregulloren QRK Nr. 20/2013. Ata identifikojnë praktikën e mirë dhe i ndajnë ato me nivelin qendror konkretisht DRPR me qëllim të shpërndarjes në të gjitha komunat. Ata raportojnë ngecjet dhe përkrahin komunat në tejkalimin e pengesave.

Në fund të çdo viti fiskal, secila komunë nxjerr raport të progresit për zbatimin e politikave të riintegritimit i cili publikohet në ueb faqen e komunës.